



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1688/1 Prot.

Tiranë, më 10.12.2021

V E N D I M

Nr. 238, Datë 10.12.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 197, datë 01.11.2021, të paraqitur nga H.H kundër Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës¹” dhe “ngjyrës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “H.H është shtetase Shqiptare, ndërsa babai i saj, i ndjeri A.H është me origjinë nga, Msarate Tarabuluz, që është Tripoli i sotëm, kryeqyteti i Libisë, i cili ka emigruar gjatë viteve 1920 në Shqipëri. Ankuesja ka aplikuar pranë ish-ZVRPP Shkodër për regjistrimin fillestar të pasurisë nr. 3/122, zk. 8592, S.Tr-706 m² nga të cilat S.ND-116 banesë një kat, me anë të kërkesës nr. 4939, datë 23.06.2014, ku janë bërë dhe pagesat përkatëse sipas shërbimit të kërkuar të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe pajisja me certifikatë pronësie. Nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr. 3769, datë 13.05.2015 i është kërkuar që të bëhet plotësim dokumentacioni për regjistrimin fillestar të pasurisë. Pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit teknik e ligjor të kërkuar, ankuesja ka vazhduar me aplikimin nr. 16643, datë 28.12.2016, dhe më pas me kërkesën nr. 7106, datë 20.04.2017 ka depozituar për regjistrim dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. 909/415 rep/kol datë 14.4.2017, lëshuar për të ndjerin babain e saj A.H, për faktin se prona vjen në origjinë të saj nga pronari, A.H. Me shkresën nr. 3651, datë 02.03.2021 të DV ASHK Shkodër, është kërkuar në vijim të kërkesës së ankueses të datës

¹ Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka adoptuar një qasje të gjerë duke e përkufizuar “diskriminimin racor” se përfshin “racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”, (ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI(2003)8, adopted 13 December 2002, par 1(b)).

23.01.2020 (plotë një vit e tre muaj nga momenti i aplikimit për herë të dhjetë në këtë zyrë prej vitit 2014) që ankuesja të depozitoj mandat pagesat për dëshminë e trashëgimisë nr. 2118, datë 13.09.2012 për të ndjerën Z.H, në një kohë që kërkuesja ka depozituar Vendim Dëshmi Trashëgimie ligjore nr. 1626/915 Rep/Kol. datë 29.05.2015 të së ndjerës Z.H me aplikimin nr. 7605, datë 22.06.2015 dhe vendimi gjyqësor i dëshmisë së trashëgimisë nr. 2118, datë 13.09.2012 është pa asnjë efekt juridik. Pra, kjo dëshmi trashëgimie nuk ka asnjë vlerë ligjore pas regjistrimit të Vendim Dëshmi Trashëgimie ligjore nr. 1626/915 Rep/Kol, datë 29.05.2015. Këto janë veprime të cilat kanë shkaktuar zvarritje në mënyrë të përsëritur të procedurës administrative dhe vonesat e paligjshme për më shumë se një vit për një përgjigje nga DV ASHK Shkodër, kanë karakter diskriminues për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës dhe origjinës, pasi ankuesja është shtetase me origjinë të babait të saj prej Sudanit, familja e të cilit gjatë mesviteve 1800 është zhvendosur dhe ka jetuar në Tripoli, Libi. Situata e paligjshmërisë e krijuar nga DV ASHK Shkodër, në të gjitha format e saj, vonesë në trajtim të praktikës dhe gabime të qëllimshme është trajtuar edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK Tiranë, ku pas trajtimit të ankesës së H.H, me shkresën nr. 6516, datë 17.03.2020 është urdhëruar që DV ASHK Shkodër: “Të vijojë me procedurën për përcaktimin e sipërfaqes së pasurisë të regjistruar në rradhorin e pronësisë me nr. 65, datë 24.01.1992, duke bërë edhe kalimin e regjistrimit nga regjistrat hipotekorë në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Kjo shkresë nuk është vlerësuar dhe as është vënë në zbatim edhe sot mbas 1 viti e 7 muaj. Kjo është situata ku ankuesja diskriminohet për shkak të racës dhe ngjyrës së lëkurës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga DV ASHK Shkodër, e cila refuzon të ofrojë shërbim për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7/1 i LMD-së², parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 197, datë 01.11.2021 të shtetases H.H, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1516/1, datë 08.11.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga DV ASHK Shkodër, për ankesën e bërë nga H.H si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të praktikës shkresore/procedurës së ndjekur nga ana e DVASHK Shkodër, lidhur me rastin e regjistrimit dhe lëshimit të dokumenteve të pronësisë për pasurinë objekt i ankesës.
 - Kopje të plotë të korrespondencës mes Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe DV ASHK Shkodër, lidhur me rastin e H.H.
 - Informacion nëse DV ASHK Shkodër, për arsye të njëjtë apo të ngjashme me ato të ankueses, ka ndjekur të njëjtën procedurë dhe të njëjtën kohëzgjatje për trajtimin e kërkesës. Nëse po, kopje të procedurës.

Me shkresën nr. 12656/1, datë 22.11.2021, Drejtoria Vendore e ASHK Shkodër, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Nga ana e trashëgimtares ligjore, H.H është kërkuar pajisje me certifikatë pronësie për pasurinë nr. 3/122, me sipërfaqe truall 706 m² nga të cilat, 116 m² sipërfaqe ndërtimore, pasuri e afishuar shtet në vol. 32, fq. 3, zk.8592, pasi zona kadastrale ka kaluar fazën e regjistrimit fillestar. Nga ana e kërkueses, pasi është njoftuar me shkresën nr. 2168, datë 17.02.2020, për plotësim dokumentacioni si, mandat pagesa të dëshmisë së trashëgimisë nr. 2118, datë 13.09.2012 për të ndjerën Z.H, me kërkesë aplikimin nr. 5953, datë 18.03.2021, është sjellur dëshmia e trashëgimisë nr. 1626/915, datë 29.05.2015, ku është çelur për A.H dhe Z.H. Pasuria e regjistruar në radhorin nr. 201, datë 16.11.1969, në favor të A.H, është e transkriptuar në radhorin nr. 244/22, datë 09.01.1992, me pronar të ri Z.H, dhe nga ana e ASHK Shkodër, në zbatim të VKM-së nr. 781, datë 07.10.2020 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, si dhe nenit 30 të Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, me Urdhër të Brendshëm nr.*

210, datë 15.11.2021 është realizuar verifikimi në terren i pasurisë nr. 3/122, ku qytetari ka marrë dijeni për urdhërin e verifikimit datë 16.11.2021 pranë zyrës për vazhdimin e procedurave. Në zbatim të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, si dhe VKM-së nr. 781, datë 07.10.2020, pas verifikimit të pasurisë, përgatitjes së fragment hartës për afishim për pasurinë nr. 3/122, ka vijuar procedura e afishimit pranë Njesisë Administrative nr. 2, Bashkia Shkodër, si dhe ambjenteve të zyrës. Në përfundim të afishimit 30 ditor, konfirmuar me shkresë përcjellëse nga Bashkia Shkodër për përfundimin e afishimit, si dhe lidhur me pretendimet, H.H do të pajiset me çertifikatë pronësie në bazë të akteve tekniko ligjore”.

Në vijim të procedurës hetimore, me shkresat e protokolluara pranë institucionit me nr. 1516/2, datë 18.11.2021 dhe nr. 1516/4, datë 01.12.2021, Komisioneri në mes të tjerash, është informuar nga ana e ankueses se: “..sot me datë 15.11.2021 jam vënë në dijeni të shkresës nr. 13053, datë 15.11.2021 të DVASHK Shkodër, në të cilin është urdhëruar: “Verifikimi në terren i pasurisë me nr. 3/122 me kërkuese H.H..... Grupi i punës të përbëhet nga..... Verifikimi do të bëhet datë 19.11.2021”. Për sa më sipër ju njoftoj për fillimin e procedurës për rregjistrimin e pasurisë dhe njëkohësisht ju falenderoj për gjithshka që keni bërë për të vënë të drejtën time për t’u pajisur me dokumentin e pronësisë..... Fillimi i procedurës administrative nga DVASHK Shkodër pavarësisht vonesës, më vendos përpara detyrimit moral të heq dorë nga ankesa..... pasi qëllimi nuk ka qenë ndëshkimi i drejtuesve apo punonjësve të kësaj drejtorie, por fitimi i të drejtës për tu pajisur me dokument pronësie.....”.

Në këto kushte, Komisioneri gjykoi se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 197, datë 01.11.2021, të H.H, për shkak se subjekti është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA